

## KOMUNIKATË PËR SHTYP

21.07.2011

### **Gazsjellësi Trans Adriatik dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë firmosin Memorandumin e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit në mbështetje të sigurisë së furnizimit me gaz në Evropën Juglindore**

**Konsorciumi TAP dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Shqipërisë (METE), ranë dakord sot që të bashkëpunojnë për zhvillimin e tregjeve të gazit natyror në Evropën Juglindore (EJL) dhe forcimin e sigurisë së furnizimit dhe diversifikimin e burimeve të gazit në rajon**

**Tirana, Shqipëri.** Gazsjellësi Trans Adriatik dhe Qeveria Shqiptare firmosën një Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi duke u përqendruar në gjetjen e mundësive për lidhjen e Gazsjellësit Adriatik-Jon (IAP), një projekt madhor rajonal i gazit natyror, me sistemin e Gazsjellësit Trans Adriatik, në një pikë lidhëse në afërsi të Fierit në Shqipëri.

Disa muaj më parë, TAP ka nënshkruar marrëveshje të ngjashme me palët e tjera pjesëmarrëse në IAP, duke përfshirë operatorin kroat të sistemit të gazit Plinacro Ltd, operatorin boshnjak të sistemit të gazit BH-Gas dhe qeverinë e Malit të Zi. TAP mbështet objektivat e këtyre vendeve për zhvillimin e mëtejshëm të tregut rajonal të gazit në EJL dhe integrimin e tij në tregun e energjisë së BE.

Duke patur marrëveshje të nënshkruara me të katër pjesëmarrësit e gazsjellësit Adriatik-Jon, TAP konsolidon kuadrin e nevojshëm për zhvillimin e mëtejshëm të lidhjes së TAP me IAP. Hapat e mëtejshëm do të përfshijnë harmonizimin e afateve kohore të projekteve dhe specifikimeve teknike të tubacioneve.

Lidhja e IAP me TAP do t'i sigurojë Evropës juglindore, një rajon i cili varet në një masë shumë të madhe nga një furnizues i vetëm i gazit, furnizime të reja të gazit natyror nga rajoni i Kaspikut. Për më tepër, kjo do të sjellë siguri të lartë të energjisë dhe përfitime ekonomike në rajon.

Kohët e fundit, rëndësia e projektit IAP u njoh nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), i cila vendosi t'i japë projektit të gazsjellësit Adriatik-Jon 3,5 milionë Euro për kryerjen e një studimi fizibiliteti dhe për vlerësimin e ndikimit mjedisor (VNM).

Konsorciumi TAP, i përbërë nga drejtues të energjisë evropiane Statoil, E. ON Ruhrgas dhe EGL, synon të ndërtojë një tubacion gazi natyror që kalon përmes Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë për të sjellë gazin e rajonit të Kaspikut në Evropë. Gazsjellësi do të jetë një komponent kryesor në hapjen e Korridorit Jugor të Gazit që synon Bashkimin Evropian. Gazsjellësi i TAP parashikohet të ketë aftësitë për të kthyer mbrapsht drejtimin e rrjedhjes, gjë që do të mbështesë gjithashtu besueshmërinë në rajon në rast të ndërprerjeve të furnizimit me energji. Sipas termave të MMB, do të ngjitet menjëherë një grup pune për të vlerësuar më tej fushat e bashkëpunimit të mundshëm, duke filluar që nga bashkërendimi i programeve në përgjithësi dhe ndarja e praktikave më të mira dhe deri te lehtësimi i mirëkuptimit të përbashkët të secilës kërkesë teknike të projektit. Kjo do të

përfshijë nevojat për kapacitete, ndërtime të reja dhe përmirësime të infrastrukturës ekzistuese si dhe vlerësimet e ndikimeve mjedisore dhe sociale.

**Nasip Naço, Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës i Shqipërisë (METE)**, u shpreh: "Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi është një element shumë i rëndësishëm në përmbushjen e Vizionit të Qeverisë Shqiptare për garantimin e furnizimit me burime energjetike, si dhe për ta shndërruar Shqipërinë në një vend strategjik për energjinë në rajon.

METE dhe dhe Projekti TAP kanë një bashkëpunim të gjatë rreth Tubacionit të Gazit Trans Adriatik dhe Shqipëria ka mbështetur plotësisht të gjitha kërkesat teknike dhe ligjore në kuadër të zhvillimit të projektit TAP.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në 18 Maj 2010 ka hyrë në një Projekt të Integruar të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me kompaninë Trans Adriatik Pipeline AG, me aksionerë kompanitë e mëdha Energjetike, si Statoil, E-On Ruhrgas, EGL.

METE dhe projekti TAP, njohin rëndësinë strategjike të Republikës së Shqipërisë, për t'u shndërruar në një vend kryesor për sigurinë e Energjisë në Bashkimin Evropian, si dhe për të diversifikuar objektivat e burimeve dhe prurjeve të gazit. Gjithashtu të dyja palët njohin rëndësinë për furnizimin me gaz, si dhe interesin nga të ardhurat fiskale, dhe përfitimet e shumta ekonomike që projekti TAP do të gjenerojë për Shqipërinë. Investimi për projektin TAP është një investim shumë serioz dhe është parashikuar të jetë mbi 1 Miliard euro, dhe do të sjellë përfitime në shumë aspekte për të gjitha vendet nëpër të cilat kalon.

Potenciali që krijohet nga lidhja e mundshme e Gazsjellësit TAP dhe Gazsjellësit IAP, krijon një sinergji pozitive duke e vendosur Shqipërinë në një nyje të rëndësishme për rrjetet e gazit në Evropën juglindore, gjë e cila do të jetë objekt i Grupit të Përbashkët të Punës ndërmjet kompanisë TAP AG dhe vendeve pjesëmarrëse në projektin IAP."

**Barnim Piechorowski, Drejtori i Zhvillimit të Biznesit dhe Lejeve të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik**, u shpreh: "Nënshkrimi i këtij MMB është një hap i rëndësishëm drejt realizimit të IAP; ai i siguron rajonit të Evropës juglindore mundësinë për të patur akses në gazin e rajonit të Kaspikut. Nga ana tjetër, ky Memorandum është gjithashtu një arritje e rëndësishme për TAP, pasi ai rrit vlerën e TAP kundrejt furnizuesve të gazit, të cilët janë të interesuar që të tregtojnë gazin e tyre në rajon. Republika e Shqipërisë është një vend kyç për të dyja projektet e gazsjellësve dhe ajo do të luajë një rol kryesor në realizimin e Korridorit Jugor të Gazit, një komponent thelbësor i politikës energjetike të Bashkimit Evropian."

#### **Pyetje nga Media**

Lisa Givert, Shefe e Komunikimeve, TAP, Celular: +41 79 536 6016, [lisa.givert@tap-ag.com](mailto:lisa.givert@tap-ag.com)

Dorian Ducka, Drejtor i Integritetit Evropian, METE, Celular: + 355 69 40 71 990, [dorian.ducka@mete.gov.al](mailto:dorian.ducka@mete.gov.al)

#### **Rreth Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)**

Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është një projekt tubacioni gazi natyror. Tubacioni do të transportojë gaz nga rajoni i Kaspikut duke kaluar nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, detit Adriatik dhe duke dalë në jug të Italisë dhe më tej në Evropën Perëndimore. Projekti ka për qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit si dhe diversifikimin e furnizimeve me gaz për tregjet evropiane. TAP do të hapë një të ashtuquajtur Korridor Jugor të Gazit në Evropë dhe do të krijojë një treg për gazin natyror nga Deti Kaspik.



Trans Adriatic Pipeline



Page 3/4

Projekti është projektuar për ta zgjeruar kapacitetin e transportit nga 10 në 20 MMK në vit. TAP gjithashtu parashikon kthimin fizik të drejtimit të rrjedhjes deri në 80% të kapacitetit të gazsjellësit dhe mundësinë e zhvillimit të objekteve të depozitimit të gazit natyror në Shqipëri për të çuar më tej sigurinë e furnizimit gjatë çdo ndërprerjeje operationale të transportit të gazit.

Aksionarët e TAP janë: EGL e Zvicrës (42.5%), Statoili i Norvegjisë (42.5%) dhe E. ON Ruhrgas i Gjermanisë (15%).

**Për më shumë informacione, ju lutem vizitoni faqen tonë të internetit, ose na ndiqni në Twitter.**

[www.trans-adriatic-pipeline.com](http://www.trans-adriatic-pipeline.com)

[www.twitter.com/tap\\_pipeline.com](https://www.twitter.com/tap_pipeline.com)

### **Rreth Gazsjellësit Adriatik-Jon (IAP)**

Projekti synon të lidhë sistemet ekzistuese dhe të planifikuara të transmetimit të gazit të Republikës së Kroacisë, nëpërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë me sistemin e TAP (Gazsjellësi Trans Adriatik).

Gazsjellësi do të kalojë nëpër territorin përgjatë bregdetit Adriatik, nga Fieri në Shqipëri deri në Split në Kroaci. Gjatësia e përgjithshme e gazsjellësit nga Spliti (Kroaci) në Fier (Shqipëri) është planifikuar të jetë rreth 516 km. Kapaciteti i tij prej 5 MMK në vit do të sigurojë furnizimin me gaz natyror për Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën, dhe Kroacinë.

Projekti i gazsjellësit Adriatik-Jon mbështet hapjen e korridorit të ri të energjisë për rajonin e Evropës juglindore dhe e lidh atë me furnizimet e reja të gazit natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni i Kaspikut. Gazsjellësi Adriatik-Jon do të funksionojë me dy drejtime, pra do të furnizojë rajonin e Evropës juglindore me gaz natyror edhe nga burime të tjera të tilla si Terminali i ardhshëm i LNG në ishullin Krk.

# TAP

Trans Adriatic Pipeline

